



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:247131  
Datë: 22.04.2024  
Numri i dokumentit: 05599088

C.nr.1116/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Q.K, nga Rahoveci të cilën e përfaqëson avokati D.M nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1,383.75 euro, jashtë seancës, me datë 22.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses Q.K.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses Q.K, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.01.2021, e deri me datën 31.01.2023, për 27% të pagës bazë (421 euro) x 27% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) = 55.35 euro x 25 muaj, t’ia paguaj shumën prej 1,383.75 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 13.11.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm”.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses Q.K, t’ia paguajë shumën prej 135.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja Q.K, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, më datën 13.11.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1,383.75 euro.

E njëjta sipas padisë ka theksuar se është në marrëdhënie pune tek e paditura. Paditësit sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili ka qenë në fuqi deri më datën 06.02.2023, nuk i është llogaritur në pagë diferenca në pagë sipas vendimit të

qeverisë. Andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen në padi të datës 05.04.2024, ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se i mungon legjitimiteti real pasiv për të qenë palë e vetme në këtë çështje kontestimore, ngase sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33 të datës 29.08.2008, në nenin 8 është përcaktuar se “Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Financave dhe Ministria e Shërbimeve Publike”. Në asnjë pikë të vendimit të përshkruar nuk është obliguar Komuna e Rahovecit që të zbatojë këtë vendim. Po ashtu ka theksuar se pas hyrjes në fuqi të ligjit për pagat në sektorin publik Ligji Nr..08/L-196, është shfuqizuar vendimi i qeveris Nr.01/33 i datës 29.08.2008. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën e punës për mësimdhënësë e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses; diplomën e datës 31.10.2013 e lëshuar nga Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës, Qendra në Gjakovë, Nr.601; licencën e mësimdhënësit Nr. 100024579 e lëshuar më datën 29.05.2017 e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për paditësen dhe listën e pagave për muajin tetor 2022 për paditësen.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësja kishte të themeluar marrëdhënien e punës me kontratë tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësja posedon licencë të mësimdhënësës. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditëses kompensimi nga marrëdhënia e punës në bazë të nivelit të shkollimit dhe kualifikimit dhe a është kërkesa e parashkruar.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënësë e datës 01.09.2015, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Q.K kishte të themeluar marrëdhënien e punës te e paditura.

Me administrimin e diplomën e datës 31.10.2013, Nr.601, e lëshuar nga Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës, Qendra në Gjakovë, gjykata vërtetoi faktin se paditësja Q.K , ka përfunduar Fakultetin e Edukimit, dhe mori titullin bachelor i Programit Fillorë.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 100024579 e lëshuar më datën e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, për paditësen, gjykata vërtetoi faktin se paditësja është licencuar me licencë të mësimdhënësit nga data 29,05,2017.

Me administrimin e listës së pagave për muajin tetor 2022 për paditësen, gjykata vërtetoi faktin se në muajin tetor të vitit 2022, paditësja Q.K, në këtë periudhë kishte pagën bazë pre 421 euro.

Kështu, gjykata ka vendosur ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses për shkak se në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, në pikën 1 të këtij vendimi përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4 të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Pra, nga përmbajtja e vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008 dhe me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet dhe kriteret sipas mënyrave të përcaktuara të licencimit dhe se në bazë të këtyre kriterëve mësimdhënësve u takon kompensimi nga marrëdhënia e punës.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t'i paguajë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim Në këtë rast paditësja Q.K, në bazë të shkallës së licencimit, për shkak se posedon diplomë të nivelit bachelor i ka takuar kompensimi nga paga bazë prej 27%. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditësve ua ka paguar shumë prej 58.32 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim, gjykata po ashtu ka analizuar edhe rregullativën nënligjore, gjegjësisht Udhëzimin Administrativ Nr.5/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë (tutje: UA) i datës 18.04.2017, në të cilin, në nenin 24 parashihen Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Komunale për Arsim, ku paragrafi 3 i këtij neni parashihet *“Siguron buxhetin për ZHP të gjithë mësimdhënësve në nivel komune”* dhe paragrafi 4 *“Zbaton Sistemin e financimit të gradimit të mësimdhënësve të lidhur me këtë UA”*. Pra në bazë të këtyre dispozitave e paditura obligohet që të sigurojë buxhet të mjaftueshëm si dhe të zbatojë sistemin e financimit lidhur me licencimin e mësimdhënësve.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit është *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e*

*paraqitjes së kërkesës*”. Prandaj edhe pretendimet e të paditurës se kërkesa për këtë periudhë kohore është parashkruar nuk qëndrojnë, pasi që padia është parashtruar me datë 13.11.2023, brenda afatit kohorë.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditëses, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.*”. Në këtë drejtim, gjykata nga shkresat e lëndës vërtetoi gjendjen faktike, pra faktin se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe kërkesëpadinë e saj e aprovoi në tërësi pasi që është e bazuar në Kontratës Kolektive të Arsimit e Kosovës si dhe në Vendimin e Qeverisë nr.01/33, datë 29.08.2008, në këtë rast gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palës së paditur, por nuk ishin relevante në zgjidhjen e kësaj çështje kontestimore.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 87 të Ligjit të Punës, Udhëzimit Administrativ Nr.5/2017, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, nenit 398 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, duke vendosur që e paditura t’ia kompensojë të paditëses shumën si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 135.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 104.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 31.00 euro.

#### GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil

C.nr.1116/2023, më datë 22.04.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale  
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari  
Avni Berisha

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.